

UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE NATYRORE

Rr. Eqrem Çabej, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381-38-249-873 • E-mail: fshmn@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

FSHMN

Ref. nr.

3595

Prishtinë,

Dt.

03.10.2025

RAPORT I VLERËSIMIT TË DORËSHKRIMIT TË PUNIMIT TE DIPLOMES
MASTER

FAKULTETI	Fakulteti i Shkencave Matematike dhe Natyrore
Departamenti/ Programi	Biologji
Projekt-propozimi	Vlerësim i përbërjes kimike dhe aktivitetit antioksidativ të lloji <i>Melissa officinalis</i> nga popullatat natyrore në Kosovë
Kandidati	Arta Peci
Mentori	Prof. Dr. Avni Hajdari
Aprovimi i projekt propozimit në Këshillin e Fakultetit	Datë: 29.07.2024
	Vendimi nr.: 2691
Vlerësimi i dorëshkrimit	<p>Tema e Master-it e titulluar "Vlerësim i përbërjes kimike dhe aktivitetit antioksidativ të lloji <i>Melissa officinalis</i> nga popullatat natyrore në Kosovë" e kandidatës Arta Peci është punuar në Departamentin e Biologjisë të Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore, përkatësisht në laboratorin e Ekologjisë së Bimëve. Tema është realizuar sipas procedurave të parapara në programin e punës të paraqitur së bashku me kërkesën për vlerësimin të projekt-propozimit të temës.</p> <p>Dorëshkrimi është shkruar në 43 faqe, me rralor 1.5, ku janë përfshirë këta kapituj: Abstrakti, Abstract (në gjuhën Angleze), Hyrja, Materiali dhe metodat e punës, Rezultatet dhe diskutimi, Përfundimi, Literatura dhe Biografia. Në punim janë prezantuar 10 figura dhe 2 tabela. Kandidatja gjatë shkruarjes së dorëshkrimit ka shfrytëzuar literaturë të mjaftueshme duke cituar 52 artikuj shkencor dhe burime tjera të literaturës.</p> <p>Në kapitullin Hyrje, kandidatja ka përshkruar rëndësinë e këtij hulumtimi, biologjinë e llojit <i>Melissa officinalis</i>, përdorimin etnobotanik, përbërjen kimike, si dhe efektet farmakologjike dhe toksikologjike të këtij lloji. Po ashtu, kandidatja ka adresuar qartë qëllimin e hulumtimit.</p> <p>Në kapitullin Materiali dhe Metodat, kandidatja ka përshkruar dizajnin e punës, mënyrën e mbledhjes së materialit bimor në terren, si dhe metodat e analizës së komponimeve bioaktive. Materialin bimor,</p>

kandidatja e ka grumbulluar në 11 lokalitete të Kosovës gjatë korrikut 2024 dhe të cilin e ka tharë në hije. Vajrat esenciale i ka izoluar me metoda HS-SPME dhe hidrodistilim, ndërsa analizën cilësore dhe sasiore e ka kryer me kromatografi të gaztë të shoqëruar me spektrometër të masës (GC-MS) dhe detektor jonizues me flakë (GC-FID). Për përcaktimin e fenoleve totale, flavonoideve totale dhe aktivitetit antioksidativ, materialin bimor e ka ekstraktuar me metanol dhe analizuar me metoda kolorimetrike.

Në kapitulli Rezultatet dhe diskutimi, kandidatja ka përfshirë dhe shqyrtuar rezultatet e gjetura për përbërjen kimike të vajrave esenciale, sasinë e fenoleve totale, flavonoideve totale dhe aktivitetin antioksidativ të llojit *Melissa officinalis*. Të dhënat për parametrat e analizuar, kandidatja i ka paraqitur në formë mesataresh në tabelat përkatëse. Për të analizuar dallimet në përbërjen kimike të vajrave esenciale ndërmjet popullatave të analizuar, ajo ka përdorur analizën e komponentëve kryesorë (PCA), ndërsa për të analizuar dallimet në sasinë e fenoleve totale, flavonoideve totale dhe aktivitetit antioksidativ, ka aplikuar analizën e variancës (ANOVA). Përveç kësaj, ka vlerësuar ndikimin e sasisë së fenolëve totalë dhe flavonoideve totale në aktivitetin antioksidativ duke përdorur analizën e korrelacionit. Gjetjet e veta kandidatja i ka krahasuar me ato të autorëve të tjerë.


Në kapitullin Përfundimi, kandidatja ka dhënë një përmbledhje të gjetjeve kryesore të këtij hulumtimi. Në bazë të rezultateve të fituara kandidatja konstaton se në përgjithësi përbërja kimike e vajrave esenciale, sasia e fenolëve totale, flavonoideve totale dhe aktivitetit antioksidativ ishte e ndryshme ndërmjet lokaliteteve. Po ashtu konstaton ekzistencën e tre kemotipave kryesorë, përkatësisht kemotipi i dominuar nga komponimet citralet, kemotipi i përzier dhe kemotipi me dominim të citronellalit, çka tregon për një diferencim të qartë kimik ndërmjet popullatave të analizuar.


Nga ajo që u tha më lart (bazuar në punën e bërë nga kandidatja) mund të konkludohet se rezultatet e fituara në këtë punim paraqesin kontribut për njohjen e përbërjes kimike dhe variabilitetit të këtyre komponime ndërmjet nga popullatave të ndryshme natyrore të llojit *Melissa officinalis* në Kosovë, ndërsa kandidatja ka fituar njohuri për hulumtime në të ardhmen në këtë lëmi.


Këshillit Shkencor-Mësimor të Departamentit të Biologjisë dhe të Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore i propozojmë që të aprovojë këtë raport dhe kandidates Arta Peci t'i lejojë mbrojtjen e temës.

Prishtinë, 02.10.2025

Komisioni:

1. 
Prof. Dr. Behxhet Mustafa – kryetar

2. 
Prof. Dr. Avni Hajdari - anëtar (mentor)

3. 
Prof. Dr. Avdulla Alija – anëtar